



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2022

Lënda: Përcillet kërkesa e shtatë deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë.

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Këtu

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 77, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 24 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni kërkesën e shtatë deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë për ngritjen e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit për Investimet Strategjike.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

KRYETARI

Enkelejd ALIBEAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2022

K Ë R K E S Ë

KËRKUES: 7 (shtatë) deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, anëtarë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

OBJEKTI: Ngritja e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit për Investimet Strategjike.

BAZA LIGJORE: Neni 77 i Kushtetutës së Shqipërisë;
Neni 24 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

DREJTUAR: **Znj. Lindita NIKOLLA**
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë.

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në datën 28.05.2015, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”. Qëllimi i këtij ligji ishte nxitja dhe tërheqja e investimeve strategjike, vendase dhe të huaja, në sektorët e ekonomisë, të identifikuar prej këtij ligji si sektorë strategjikë, nëpërmjet vendosjes së procedurave të posacme administrative favorizuese, lehtësuese apo përshpejtësuese të mbështetjes e të shërbimeve ndaj investitorëve (*shih nenin 1*).

Me investime strategjike, ligji ka përcaktuar ato investime që kryhet në një nga sektorët ekonomikë strategjikë, sipas përcaktimeve të vetë ligji (*shih neni 3, pika 6*). Si të tillë, janë konsideruar sektorët (i) energjetik dhe minerar; (ii) transport, infrastrukturë e komunikimeve elektronike dhe mbetjet urbane; (iii) turizëm (struktura turistike); (iv) bujqësi (ferma e madhe bujqësore) dhe peshkim; (v) zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik; dhe (vi) zona me përparësi zhvillimi (*shih nenin 8*). Në ligj janë detajuar edhe vlera e investimit dhe numri i punonjësve për secilin sektor.

Për zbatimin e këtij ligji, është parashikuar ngritja e Komitetit të Investimeve Strategjike, një komitet ndërministror, i kryesuar nga Kryeministri dhe në përbërje të tij janë zv.kryeministri, ministri i Financave dhe Ekonomisë, ministri i Turizmit dhe Mjedisit, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Bujqësisë dhe Avokati i Përgjithshëm i Shtetit (*shih nenin 9*). Kompetenca kryesore e këtij Komiteti është miratimi i statusit “Investim/investitor strategjik”, e cila nënkupton dhënien e një sërë masash mbështetëse për personin juridik privat,

vendas apo i huaj, përfshirë edhe vënien në dispozicion të pasurive të paluajshme shtetërore apo shpronësimet për interes publik (*shih nenet 26–31*).

Ligji parashikonte se afati i fundit për paraqitjen e kërkesave nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitim të statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e vecantë”, është data 31 dhjetor 2018 (*shih nenin 36*). Megjithatë, ligji është ndryshuar pesë herë, ndryshimi i fundit i bërë në datën 20.12.2021, me ligjin nr. 130/2021 “Për një ndryshim në ligjin nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, ku afati është shtyrë deri në datën 31 dhjetor 2023.

Në relacionin e këtij projektligji thuhet “Shtyrja e këtij afati është miratuar edhe më parë pasi nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është në proces hartimi i një projektligji “Për investimet”, i cili ka lindur si domosdoshmëri, pasi legjislativi në fuqi në Republikën e Shqipërisë i jepte një mbrojtje shtesë investimeve të huaja, por jo atyre vendase, ndërkohë që një korpus i ri ligjor më vete ishte krijuar për investimet strategjike.” (*shih fq. 1 të relacionit*)

Megjithëse qëllimi i këtij ligji, pra mbështetja dhe nxitja e investimeve, vendase dhe të huaja, në sektorët strategjikë për zhvillimin e ekonomisë së vendit, ishte pozitiv, në praktikë ka rezultuar se ai është përdorur kryesisht si një mekanizëm për t’u dhënë favore dhe përfitime njerëzve me lidhje të forta personale apo familjare pranë qeverisë dhe drejtuesve të Partisë Socialiste. Në cdo rast, mbi këto projekte ka pasur hije dyshimi për korrupsion, favorizim, klientelizëm dhe arbitraritet. Ndërkohë, që shifra në numër projektesh apo vlerë investimesh, të përfutur nga investitorë të huaj mbeten modeste.

Në media janë publikuar edhe së fundmi disa raste, të cilat ngrejnë dyshime të forta për paligjshmëri, korrupsion dhe klientelizëm, të tilla si: (i) rasti i Portit të Durrësit; (ii) rasti i anëtarit të Këshillit Bashkiak Tiranë (PS), z. Gazmend Paja, i cili ka përfutur 133 mijë m² në Dhërmi; dhe (iii) rasti i bashkëshortit të ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe deputetes së PS-së, znj. Olta Xhacker, ish-deputeti socialist z. Artan Gaci, i cili ka përfutur të drejtën e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit që po ndërtohet në fshatin Gjilekë të bashkisë Himarë.

Këto raste, por edhe të tjera të miratuara nga Komiteti i Investimeve Strategjike, kanë nxitur aludime të ndryshme mbi qëllimet e këtij ligji, të cilat kërkojnë të vlerësohen me seriozitet dhe përgjegjshmëri nga legjislativi. Kjo duke pasur parasysh edhe faktin se aktualisht (*të paktën sipas relacionit sipërcituar*) pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është duke u draftuar një projektligj “Për Investimet”, i cili synon të ofrojë mbështetje kryesisht për investitorët vendas.

Në këtë kuptim, me qëllim shqyrtimin e të gjitha praktikave të deritanishme të ndjekura nga Komiteti, vlerësimin e mundësisë për hartimin e ndryshimeve ligjore në ligjin nr. 55/2015 “Për

Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë” me qëllim parandalimin e të gjitha praktikave të paligjshme, abuzive apo korruptive, si dhe në kushtet kur Kuvendit do t’i paraqitet shumë shpejt një projektligj “Për Investimet”, pasur parasysh edhe rëndësinë thelbësore që ka për ekonominë tonë rritja e përthithjes së investimeve vendase dhe të huaja, nëpërmjet procedurave të ligjshme, transparente dhe meritokratike, cmojmë të nevojshme ngritjen e një Komisioni të Posacëm Parlamentar për Investimet Strategjike.

Kërkesa për ngritjen e një Komisioni të Posacëm për Investimet Strategjike, bazohet në nenin 77, pika 1 e Kushtetutës, i cili parashikon se: “Kuvendi zgjedh nga gjiri i tij komisione të përhershme, si dhe mund të caktojë komisione të posacme.”, si dhe neni 24 i Rregullores së Kuvendit, i cili parashikon se “1. Kuvendi mund të vendosë krijimin e një komisioni të posacëm për shqyrtimin dhe përgatitjen e nismave ligjvënëse, si dhe për çështje të një rëndësie të vecantë. 2. Propozimi për krijimin e komisionit të posacëm mund të bëhet nga kryetari i Kuvendit, nga një komision i përhershëm ose nga të paktën 7 deputetë.”








Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, ne, një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, bazuar në nenin 77, pika 1 të Kushtetutës dhe nenin 24, pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit,

KËRKOJMË:

1. Ngritjen e një Komisioni të Posacëm të Kuvendit për Investimet Strategjike.
2. Komisioni ka për objekt të veprimtarisë së tij: (i) shqyrtimin e të gjitha praktikave të deritanishme të ndjekura nga Komiteti i Investimeve Strategjike; (ii) hartimin e ndryshimeve ligjore në ligjin nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”; dhe (iii) shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit “Për Investimet”.
3. Anëtaësia e Komisionit formohet me pjesëmarrjen e partive parlamentare, me përbërje të barabartë mes Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.
4. Komisioni e ushtron veprimtarinë për një afat 6-mujor nga data e miratimit të këtij vendimi.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

DEPUTETËT

1. Gazment Barolli 
2.  Arshavir Sula
3.  Jurele Todor
4.  Shkurto Cup
5.  Lefter Gështerija
6.  Arta Bealliu
7. FERDINAND XHAFERAJ 



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

VENDIM

Nr. ____/2022

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM TË KUVENDIT
PËR INVESTIMET STRATEGJIKE**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

I. Ngritjen e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit për Investimet Strategjike.

II. Komisioni i Posaçëm ka për objekt të veprimtarisë së tij:

- (i) shqyrtimin e të gjitha praktikave të deritanishme të ndjekura nga Komiteti i Investimeve Strategjike;
- (ii) hartimin e ndryshimeve ligjore në ligjin nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”; dhe
- (iii) shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit “Për Investimet”.

III. Komisioni i Posaçëm ngrihet mbi bazën e barazisë pozitë-opozitë. Në përbërje të tij do të ketë 14 anëtarë, nga të cilët 7 janë përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe 7 janë përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Emrat e anëtarëve të tij përcaktohen me vendim të Kuvendit.

IV. Komisioni i Posaçëm do të kryesohet nga dy bashkëkryetarë, 1 nga pozita, PS, dhe 1 nga opozita, PD.

V. Komisioni i Posaçëm do të zhvillojë veprimtarinë e tij në një afat kohor 6-mujor, nga data e miratimit të këtij vendimi. Në rast nevoje, me kërkesë të arsyetuar të bashkëkryetarëve të tij, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së komisionit.

VI. Çdo parti tjetër parlamentare, e cila nuk është e përfshirë në këtë komision, ka të drejtë të bëjë propozime.

VII. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme, kur në to janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimmarrja e komisionit do të synojë të arrijë konsensusin për të gjitha propozimet e marra. Vendimet e Komisionit quhen të miratuara me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, por vetëm kur kanë njëkohësisht konsensusin e të dy bashkëkryetarëve.

VIII. Ngarkohen Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni të Posaçëm.

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R J A

Lindita NIKOLLA

Miraturar në datën _____._____.2022